



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS FRËNGE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Fonetikë

Ngarkesa: 4 ECTS, 40 orë 15 leksione, 25 seminare

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Semestri kur zhvillohet: Viti i parë, semestri II

Programi i studimit: “Bachelor në Gjuhë Frënge”

Kodi i Etikës: Kodi i Etikës i Universitetit të Tiranës (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE E LËNDËS DHE REZULTATET E TË NXËNIT

Objektivat e përgjithshme lëndore:

Studimi i Fonetikës si lëndë bazë e gjuhës frënge dhe përvetësimi i mirë i gjuhës së dytë të folur, e cila zë një pozicion kyç në gjuhën verbale. Duke u kujdesur jo për përmbajtjen, por për të gjitha dukuritë e shprehjes së të folurit, lënda zhvillohet si studim i "tingujve, fonemave dhe shqiptimit të mirë", si shkencë e saktë, si disiplina gjuhësore më e zhvilluar, por edhe si fytyra "e fshehtë" e gjuhës. Duke marrë parasysh rëndësinë, ky kurs i destinuar për studentët e vitit të parë, synon t'u ofrojë studentëve një pamje të përgjithshme të aspekteve fonetike dhe fonologjike të frëngjishtes, duke përfshirë edhe elementet e prozodisë së saj, të shoqëruar me ushtrime praktike. Ai ofron njohuri bazë të fonetikës artikuluese, fonetikës akustike, fonologjisë dhe dukurive prozodike, të cilat përbëjnë thelbin e programit. Kjo bazë teorike rezulton thelbësore në trajnimin bazë dhe të vazhdueshëm të studentëve të frëngjishtes.

Ky cikël leksionesh synon të paraqesë nocionet më të dobishme, jo vetëm për mësuesit e ardhshëm të frëngjishtes, të cilët në praktikën e përditshme duhet t'i përkushtohen detyrës së vështirë të mësimdhënies së FLE-së dhe përsosjes së shqiptimit të saj, por edhe për të gjithë ata që kujdesen për natyrën dhe përsosjen e të folurit, për shqiptimin e mirë dhe korrekt të frëngjishtes, qofshin ato në fushën e përkthimit/interpretimit, turizmit apo medias.

Objektivat e specifike lëndore:

Cikli i leksioneve të Fonetikës synon t'i aftësojë studentët:

- të kryejnë, në bazë të veçorive të ndryshme, përshkrimin artikulues dhe akustik të tingujve të frëngjishtes si gjuhë e huaj, si nga pikëpamja e tingujve përbërës të zinxhirit të të folurit ashtu edhe si njësi mbisegmentale (prozodi).
- të bëjë të njohur alfabetin fonetik francez (APF) dhe API - të gjurmojë paraqitjet skematike, tabelore që sintetizojnë dhe vizualizojnë më mirë tingujt e frëngjishtes dhe përshkrimet e tyre.
- të interpretojë sistemin e zanoreve (gojore dhe hundore) dhe sistemin bashkëtingëllor të frëngjishtes.